



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0004191-2/ dt. 02.02.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 12 dhe 15 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, dhe Propozim – Vendimin Nr. 01-020/04-0004191/26, dt. 23.01.2026, të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit AD – HOC për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara tek Bizneset me Rastin e Fatkeqësive Natyrore – Vërshimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. Formohet Komisioni AD – HOC për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara tek Bizneset me Rastin e Fatkeqësive Natyrore – Vërshimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Florent Abrashi – Kryetar, (DPU);
 - 1.2. Besnik Rexha – Anëtar (DZHETI);
 - 1.3. Florije Ibishi – Anëtare, (DZHETI);
 - 1.4. Blerim Hyseni – Anëtar, (DI);
 - 1.5. Agron Sylejmani – Anëtar, (DI).
2. Detyrë e Komisionit të lartcekur është të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara tek bizneset me rastin e vërshimeve të krijuara në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe përgatitjen e Raporteve pas Vlerësimit në përputhje me Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.
3. Komisioni obligohet që punën ta kryej sipas kërkesës së Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera i formuar në Nivel të Komunës, dhe Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, dhe pas çdo pune të kryer të hartoj Raportin me Shkrim.

4. Pas përfundimit të punëve dhe hartimit të Raportit të Punës, i njëjti Raport i dorëzohet Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve në Rastet e Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera në Nivel të Komunës.
5. Komisioni bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
6. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim, konkretisht dorëzimin e raportit tek Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve në Rastet e Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera në nivel të Komunës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës
Faton PEÇI

SIGN HERE



Shtojcë:

Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0004191/26, dt. 23.01.2026, nga Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë;
Email-i i dt.23.01.2026, nga z. Besim Beka, Kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve në Rastet e Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera;
Vendimi Nr. 01-020/04-0104835/22, dt. 23.11.2022;
Vendimi Nr. 01-020/04-0114631-2/22, dt. 06.01.2023.

T'i dorëzohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë Siguri dhe Emergjencë
1x1 Anëtarëve të komisionit
1x1 Arkivit